

Mbështetur në nenin 44 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 6 dhe 8 të Ligjit për Asociim në Organizatat Joqeveritare, shpallur në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, Nr. 14 të datës 9 shtator 2011, Kuvendi i Shoqatës së Grave të Policisë së Kosovës i mbajtur më 23/07/2013, miratoj

## **S T A T U T I N E SHOQATËS SË GRAVE NË POLICINË E KOSOVËS**

### **I DISPOZITAT HYRËSE**

#### **Neni 1 Dispozitat e përgjithshme**

Me këtë Statut rregullohet themelimi, emërtimi, selia dhe vendi i veprimtarisë së Shoqatës së Grave në Policinë e Kosovës, përfaqësimi, synimet dhe veprimtaria për arritjen e këtyre synimeve, publiciteti i punës, procedurat për zgjedhjen dhe largimin e anëtarëve, kushtet për anëtarësim, të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të Shoqatës, organizimi i brendshëm, organet e Shoqatës, përbërja e tyre, autorizimet, mënyra e vendosjes, kriteret e zgjedhjes dhe shkarkimit, zgjatja e mandatit dhe përgjegjësia e anëtarëve, pasuria, disponimi me të dhe përdori i fitimit të mundshëm, mënyra e fitimit të pasurisë, ndërprerja dhe procedurat me pasurinë në rast të pushimi të veprimit të Shoqatës si dhe çështje të tjera lidhur me aktivitetet dhe veprimet e Shoqatës.

#### **Neni 2 Emërtimi**

1. Emërtimi i Shoqatës është: SHOQATA E GRAVE NË POLICINË E KOSOVËS/UDRUŽENJE ŽENA KOSOVSKE POLICIJE/ASSOCIATION OF WOMEN IN KOSOVO POLICE. Emërtimi i shkurtër: SHGPK/UŽKP/AWKP;
2. Selia e Shoqatës është: Rr. Luan Haradinaj nr.99, 10000 Prishtine, Republika e Kosovës.

#### **Neni 3 Statuti**

1. Shoqata është organizatë e anëtarësisë dhe ka statutin e organizatës jo qeveritare dhe jo profitabile.
2. Shoqata është e regjistruar pranë departamentit përkatës në Ministrinë e Administratës Publike.
3. Statuti ligjor i Shoqatës është në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-57 Për lirinë e asociimit në organizatat joqeveritare.

#### **Neni 4 Simboli**

1. Shoqata ka simbolin e saj, i cili përbëhet nga një rreth dy unazor, me diametër të jashtëm tetë (8) centimetra, ndërsa pjesa e brendshme gjashtë (6) centimetra me ngjyrë të kaltër në të errët, në të cilin me shkronja të mëdha është mbishkrimi në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze SHOQATA E GRAVE NË POLICINË E KOSOVËS / UDRUŽENJE ŽENA KOSOVSKE POLICIJE / ASSOCIATION OF WOMEN IN KOSOVO POLICE. Ndërsa, prapavija e simbolit është me ngjyrë të bardhë, në të cilën është i vendosur distinktivi me ngjyrë të kaltër në të errët dhe ngjyrë të verdhë, që është ngjashëm me distinktivin e Policisë së Kosovës. Në pjesën ballore është emblema në formë të shkronjës "V", ku në pjesën e epërme të saj është mbishkrimi "POLICE" me shkronja të mëdha shtypi dhe me ngjyrë të bardhë. Në pjesën qendrore të simbolit, me ngjyrë të kaltër në të errët, është i vendosur profili dysh i femrës, njëra me ngjyrë të bardhë e tjetra me ngjyrë të kaltër në të errët. Në anën e djathtë të profilit, është e vendosur harta e Kosovës në miniaturë me ngjyrë të verdhë.
2. Distinktivi zë pjesën qendrore të rrethit, ku të gjitha rrezet përfaqësojnë kanë gjatësi/diametër të barabartë, nga pesë (5) centimetra, rrezet janë dyngjyreshe me ngjyrë të kaltër në të errët dhe ngjyrë të verdhë.

#### **Neni 5 Vula e Shoqatës**

1. Vula e Shoqatës ka formë të rrumbullakët me diametër 4cm, në të cilën shkruan: "Shoqata e Grave të Policisë së Kosovës". Mbishkrimi i cekur si më lartë figuron në të tri gjuhët: shqip, serbisht dhe anglisht. Në pjesën qendrore të vulës, figuron logoja apo simboli i Shoqatës, me përshkrim të cekur si në Nenin 4 të këtij Statuti.

#### **Neni 6 Përfaqësimi**

1. Shoqatën e përfaqëson Kryetarja e Shoqatës, ndërsa Bordi Drejtues mund të autorizoj edhe persona të tjerë për ta përfaqësuar Shoqatën.
2. Përfaqësuese e autorizuar e Shoqatës në Kosovë është Kryetarja e Shoqatës së Grave të Policisë së Kosovës, Prishtinë, Republika e Kosovës.

## **II QËLLIMI DHE VEPRIMTARIA E SHOQATËS**

#### **Neni 7 Qëllimi**

Qëllimet e Shoqatës janë:

1. Fuqizimi i rolit dhe pozitës së gruas në Policinë e Kosovës.
2. Ngritja e vetëdijes dhe adresimi i çështjeve që prekin gratë në kuadër të Policisë së Kosovës.
3. Promovimi dhe ndihma në zbatimin e parimeve të barazisë dhe jo diskriminimit në Policinë e Kosovës.
4. Zhvillimi i vazhdueshëm profesional i të gjitha grave në Policinë e Kosovës.
5. Zhvillimi dhe pjesëmarrja në rrjetet profesionale dhe sociale në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar.
6. Prezantimi në media, diskutime publike, si dhe mjete tjera të përshtatshme me qëllim të ngritjes së vetëdijes institucionale dhe publike lidhur me rolin dhe rëndësinë e pjesëmarrjen e grave në Polici.

### **Neni 8 Aktivitetet**

Për të arritur qëllimet, Shoqata përmes organeve drejtuese mund të:

1. Bashkëpunojë me organe qeveritare dhe joqeveritare.
2. Organizojë fushata të përbashkëta me OQ dhe OJQ vendore dhe ndërkombëtare, me qëllim të informimit, edukimit dhe avokimit lidhur me çështje të rëndësishme të të drejtave të grave në Kosovë.
3. Organizon trajnime të avancuara dhe edukim të grave në Policinë e Kosovës.
4. Realizon aktivitete tjera të cilat ndihmojnë në arritjen e qëllimeve të përcaktuara.
5. Shfrytëzojë të hyrat e shoqatës vetëm për promovimin e qëllimeve të saja, të cilat përcaktohen me këtë Statut.

### **Neni 9 Anëtarësia dhe liria e anëtarësimit**

1. Çdo person i punësuar në Policinë e Kosovës gëzon të drejtën e plotë për t'u anëtarësuar në Shoqatë. Anëtarësimi në Shoqatë është i hapur për çdo person pa marrë parasysh racën, gjininë, gjuhën, orientimin seksual, shtetësinë, kombësinë, religjionin, moshën ose aftësitë fizike, etj.
2. Asnjë person nuk obligohet që të anëtarësohet kundër vullnetit të tij dhe asnjë person nuk diskriminohet në asnjë mënyrë për shkak të vendimit për t'u anëtarësuar apo për të mos u anëtarësuar

3. Kusht i anëtarësimit do të jetë që të gjithë personat që pranojnë anëtarësimin në Shoqatë do të konsiderohet se i kanë pranuar kushtet e Statutit dhe rregullat tjera të cilat do të aprovohen më vonë.

4. Kuvendi i Shoqatës do të vendos për rregullat dhe procedurat e pagesës së anëtarësisë, përfshirë edhe marrjen e masave të ndryshme deri te përjashtimi i anëtarit nga anëtarësia e shoqatës. Mos pagesa e anëtarësisë, pas paralajmërimit me shkrim, do të shërbejë si bazë për përjashtimin e anëtarit nga Shoqata.

#### **Neni 10 Kartela e anëtarësisë**

1. Anëtarëve të Shoqatës iu jepet kartela e anëtarësisë.
2. Dukjen, përmbajtjen dhe mënyrën e dhënies së kartelës së anëtarësisë e përcakton Bordi i Shoqatës me vendim të veçantë.

#### **Neni 11 Dorëheqja, Suspendimi dhe Largimi i anëtarëve dhe delegateve**

1. Çdo anëtar dhe delegat mund të jap dorëheqje nga Shoqata, duke ia parashtruar Sekretares një njoftim me shkrim. Anëtarësimi i ndonjë anëtari apo delegati mund të përfundojë ose suspendohet me vendimin e Kuvendit në rast të mos respektimit të Statutit apo mos respektimit të qëllimeve të Shoqatës. Në rast të suspendimit, kohëzgjatja e suspendimit do të përcaktohet me vendim.
2. Përfundimi ose suspendimi i anëtarësimit apo delegatit nga Kuvendi do të vendoset me shumicë vote të delegateve prezent në kuvend.

#### **Neni 12 Kategoritë e anëtarësisë**

1. Shoqata do të ketë katër (4) kategori të anëtarësimit, dhe atë: anëtar i rregullt, anëtar (shoqëruar) i asociuar, anëtar i nderit dhe anëtar bashkëpunues.
2. Anëtarësimi i rregullt në Shoqatë do t'iu sigurohet:
  - 2.1. Të gjitha kategorive të personelit policorë, të përcaktuar me Ligjin për Policinë e Kosovës.
  - 2.2. Të gjithë pjesëtarëve të agjencive për zbatimin e ligjit që veprojnë në Kosovë, pas miratimit të tyre nga ana e të Bordit Drejtues dhe Kuvendit.
  - 2.3. Të gjithë ish-pjesëtarëve të Policisë dhe të agjencive për zbatimin e ligjit, nga nën paragrafi (2.1) dhe (2.2), të cilët gëzonin reputacion të mirë në momentin e skadimit të anëtarësimit të tyre dhe të cilët vazhdojnë të kenë reputacion të mirë.

3. Anëtar të Asociuar (shoqërues) në Shoqatë mund të përfshihen:

- 3.1. Të gjithë personat që janë trajnuar, kanë përvojë apo njohuri tjera profesionale, sipas përcaktimeve të Bordit Drejtues dhe të cilët janë të sponzoruar nga një anëtar i Shoqatës me të drejta të plota.
- 3.2. Anëtarët e Asociuar do t'i gëzojnë të gjitha privilegjet e anëtarësisë së plotë, përveç të drejtës së votës dhe të drejtës për të mbajtur pozita zyrtare në Shoqatë.

4. Anëtar të nderit në Shoqatë mund të përfshihen:

Sipas rekomandimit të Bordit Drejtues, Kuvendi i Shoqatës, me shumicë të thjeshtë votash të delegateve të pranishëm, mund të zgjedhë anëtar nderi. personat e respektuar, profesionet dhe interesat e të cilëve janë të ngjashëm me ato të anëtarëve të rregullt. Anëtarët e nderit do të kenë të gjitha të drejtat dhe privilegjet e anëtarëve me të drejta të plota, përveç mbajtjes së pozitave zyrtare në Shoqatë dhe drejtës së votimit. Ato nuk do të detyrohen të paguajnë pagesën për anëtarësim dhe anëtarësimi i tyre do të jetë i përjetshëm. Në rast se një anëtar nderi nuk i plotëson kriteret sipas mendimit të Bordit Drejtues, anëtarësimi mund t'i ndërpritet menjëherë dhe vendimi për këtë ndërprerje do të miratohet në takimin e përgjithshëm të radhës. Njoftimi me shkrim do t'i përcaktojë edhe arsyet për ndërprerjen e anëtarësisë.

5. Anëtar mbështetës të Shoqatës mund të përfshihen individët dhe subjektet:

Çdo subjekt i organizuar si shoqatë apo korporatë e interesuar për të punuar në arritjen e qëllimeve të shoqatës që e ka paguar anëtarësimin vjetor që mund të kërkohet. (Të gjitha subjektet e tilla në këtë Statut do të quhen 'Organizata anëtare'). Anëtarët mbështetës do t'i kenë të gjitha të drejtat dhe privilegjet e anëtarëve me të drejta të plota, përveç mbajtjes së posteve zyrtare dhe votimit.

### III ORGANET E SHOQATËS

#### Neni 13 Organet e Shoqatës

Organet e Shoqatës janë:

- Kuvendi;
- Kryetarja;
- Bordi Drejtues.

#### Neni 14 Kuvendi

1. Kuvendi është organi më i lartë i Shoqatës.

2. Kuvendi zgjedhor është i përberë nga të gjithë anëtarët e Shoqatës.
3. Kuvendi i rregullt përbëhet prej të gjithë delegateve të shoqatës të zgjedhur nga kuvendi zgjedhor dhe përbëhet nga secili rajon policor, duke përfshirë edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë, Policia Kufitare i përgjigjet rajoni policor nën përgjegjësinë territoriale të caktuar.
4. Një delegat përfaqëson 10 anëtarë të rajoneve policore duke përfshirë edhe Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë.
5. Çdo rajon policor duke përfshirë edhe Drejtorinë e Përgjithshme bëhet pjesëtimi 1/10 e anëtarësisë që do të përfaqësohen në raste kur mbetja është mbi 5 anëtarë, atëherë bëhet shtimi edhe i një anëtari i cili është në ranglistën meritore të votuar.
6. Pas nominimit të delegateve dhe votimit nga anëtarët e shoqatës të rajonit të caktuar, atëherë fillon zgjedhja e delegateve sipas votave nga me e votuara.
7. Delegatja e cila merr më së shumti vota nga rajoni policor duke përfshirë edhe Drejtorinë e Përgjithshme emërohet drejtpërsëdrejti anëtare e bordit drejtues.
8. Zgjedhja e delegateve i paraprin zgjedhjes së rregullt të Kryetares së Shoqatës dhe këto zgjedhje udhëhiqen nga Bordi Drejtues.
9. Zgjedhja e Kryetares së Shoqatës bëhet nga votimi i delegateve të Kuvendit.
10. Të gjithë delegatet e shoqatës kanë të drejtë pjesëmarrjeje në takimet e Kuvendit.
11. Kuvendi mund të jetë i rregullt, zgjedhor dhe i jashtëzakonshëm.
12. Kuvendi i rregullt mbahet së paku një herë brenda një viti, ndërsa kuvendi zgjedhor mbahet në çdo katër (4) vjet.
13. Delegatet zgjedhën për mandat katërvjeçar (4).
14. Votimi do të bëhet me vota të fshehta ndërsa pas numërimit të votave rezultatet e votimit do të prezantohen para Kuvendit.

### **Neni 15 Mbledhjet e Kuvendit**

1. Mbledhjet e kuvendit i thërret bordi drejtues me vetiniciativë. Në vendimin mbi thirrjen e Kuvendit, Bordi Drejtues përcakton rendin e ditës të mbledhjes, ditën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes.
2. Kuvendi do të takohet së paku një (1) herë në vit në Mbledhjen e Rregullt Vjetore, në kohën dhe vendin e përcaktuar nga Bordi Drejtues, ku shqyrtohet dhe miratohet raporti për mjetet, detyrimet, të hyrat, shpenzimet dhe programet e shoqatës për vitin e kaluar, si dhe plani për mjetet, e detyrimet e parapara, të hyrat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm.
3. Kuvendi mund të takohet gjithashtu edhe në Mbledhjen Jashtëzakonshme kurdoherë që kërkohet nga gjysma e delegateve ose nga Bordi Drejtues. Një kërkesë e tillë duhet t'i drejtohet Sekretarit i cili do të lajmërojë për takimin të gjithë delegatet, në pajtim me procedurat të shpjeguara në këtë Statut.
4. Lajmërimi me shkrim për mbajtjen e Kuvendit, cilido qoftë ai, duke përfshirë datën dhe vendin e mbajtjes së mbledhjes, së bashku me rendin e ditës për takimin do t'u shpërndahet të gjithë delegateve së paku shtatë ditë para ditës së mbajtjes së mbledhjes.

5. Për mbajtjen e mbledhjes më së paku është e nevojshme pjesëmarrja e 50% + 1 e delegateve. Nëse ky minimum (kuorumi) nuk arrihet përmes konfirmimit për pjesëmarrje në takim, atëherë takimi do të shtyhet për një ditë tjetër të përcaktuar më vonë dhe lajmërimi i ri do t'u dërgohet të gjithë anëtarëve.
6. Secili delegat i shoqatës ka një votë në Kuvend. Vendimet në Kuvend do të merren me shumicën e delegateve prezent.
7. Secili anëtar i Kuvendit mund të abstenojë nga votimi ose marrja e vendimit në çfarëdo çështje për të cilën ai ose ajo ka interes personal ose ekonomik.

### **Neni 16**

#### **Drejtimi dhe vendimet e Kuvendit**

1. Kuvendin e drejton si dhe vendimet i nënshkruan Kryetarja e Shoqatës. Në rast të mungesës së Kryetares së Shoqatës, nënkryetari i Shoqatës, si dhe do të udhëheqë me seancë dhe do të nënshkruan vendimet që merren në Kuvend.
2. Për punën e seancës së Kuvendit mbahet procesverbal, të cilin e nënshkruajnë Kryetarja dhe procesmbajtësi. Procesverbali ruhet përgjithmonë në arkivin e Shoqatës.
3. Kuvendi i Shoqatës, si organi më i lartë drejtues, ka përgjegjësi të plota për çështje të politikës dhe financave të Shoqatës dhe takohet të paktën një herë në vit, në mbledhjen ku shqyrtohet dhe miratohet:
  - raporti për mjetet;
  - detyrimet, të hyrat;
  - shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e kaluar;
  - plani për mjetet e detyrimet e parapara, të hyrat, shpenzimet dhe programet e organizatës për vitin e ardhshëm.

### **Neni 17**

#### **Caktimi i mbajtjes së Kuvendi**

1. Shoqata do të mbajë Kuvendin çdo vit kalendarik në formë të Kuvendit të rregullt.
2. Bordi Drejtues do të përcaktoj kohën dhe vendin e mbajtjes së takimit si dhe të bëjë njoftimet paralajmëruese.
3. Kurdo që e konsideron të arsyeshme, Bordi Drejtues mund të thërret Kuvend të jashtëzakonshëm, për të trajtuar çështje të cilat të Bordit Drejtues i konsideron të nevojshme. Kuvend të jashtëzakonshëm mund të thërret edhe Sekretarja në rast të pranimit të kërkesës përkatëse nga 1/3 e delegateve të Shoqatës.
4. Për mbajtjen e Kuvendit të rregullt, delegatet e Shoqatës njoftohen së paku katërmëdhjetë (14) ditë para mbajtjes së tij. Njoftimi për mbajtjen e kuvendit do të specifikojë vendin, datën dhe kohën e takimit dhe natyrën e çështjeve që do të

trajtohen.

### **Neni 18**

#### **Procedura e punës të Kuvendit**

1. Kuvendi i rregullt, punimet do t'i zhvilloj kur të pranishëm janë 50% + 1 të delegateve.
2. Kuvendit të rregullt nëse nuk ka kuorum, takimi do të shtyhet për një kohë dhe lokacion tjetër, të cilën do ta përcaktojë Bordi Drejtues, ndërsa njoftimi për mbajtjen e kuvendit të mëvonshëm do të jepet në të njëjtën mënyrë me dhënien e njoftimit për takimin e shtyrë.
3. Kryetarja e Shoqatës do të kryesojë Kuvendin e rregullt në cilësinë e kryesuesit të tyre, ndërsa në mungesë të Kryetares me punimet do t'i udhëheqë Nënkryetari i Shoqatës apo një anëtar i Bordit Drejtues i pranishëm në takim i cili zgjedhet nga të pranishmit për t'i udhëhequr punimet.
4. Kryetarja, me pëlqim të personave të pranishëm, mund ta ndryshojë kohën, vendin e mbajtjes së kuvendit. Kurdo që një mbledhje shtyhet për tridhjetë ditë apo më shumë, njoftimi për mbledhjen që do të mbahet më vonë do të dërgohet në mënyrë të ngjashme me njoftimin e dërguar për mbledhjen e cila është shtyrë.
3. Në Kuvendin e rregullt, vendimet e vëna për votim do të miratohen me vota të fshehta (për, kundër dhe abstenim).
6. Të gjithë delegat e Shoqatës të pranishëm në takim do të kenë të drejtë në një votë, përveç anëtarëve të asocuar, anëtarëve të nderit apo anëtarëve mbështetës, të cilët nuk kanë të drejtë vote.
7. Kuvendi do të votoj me vota të fshehta për emërimin e Kryetares, Nënkryetares dhe Sekretares.
8. Për votim të Kryetares, Nënkryetaren dhe Sekretaren duhet të jenë së paku dy (2) nominime.
9. Të nominuarit për Kryetaren, Nënkryetaren dhe Sekretaren duhet të ketë përvojë menaxheriale, të ketë reputacion brenda dhe jashtë organizatës, kredibilitet, autoritet si dhe aktive në çështje të drejtave të grave.

### **Neni 19**

#### **Kryetarja- detyrat dhe përgjegjësitë**

1. Kryetarja e Shoqatës përfaqëson Shoqatën dhe Bordin Drejtues.
2. Kryetarja e Shoqatës në raste të veçanta merr vendime nëpërmjet një konsulte të thjeshtë apo pa të, lidhur me punën apo veprimtarinë e Shoqatës.



3. Kryetarja e Shoqatës është edhe Kryesuese e Bordit Drejtues.
4. Thërret dhe udhëheqë Kuvendin siç është paraparë me këtë Statut.
5. Kryetarja e Shoqatës mbikëqyr realizimin e projekteve të cilat janë në funksion të realizimit të misionit të SHGP-së .
6. Kryetarja e Shoqatës koordinon aktivitetet dhe nxjerr vendimet e nevojshme për implementimin e projekteve të cilat realizohen nga SHGP-ja.
7. Zbaton dhe respekton vendimet e Kuvendit dhe Bordit.
8. Koordinon, menaxhon dhe delegon detyrat dhe përgjegjësitë të Anëtarët e Bordit, Nënkyetares, Sekretares si dhe delegatë apo anëtarë tjerë të Shoqatës.
9. Raporton për punën dhe veprimtarinë e Shoqatës para Bordit dhe Kuvendit, siç është paraparë me këtë Statut.
10. Kryen edhe detyra të tjera që mund të parashihen e që janë në përputhje me këtë Statut.
11. Kryetarja përfaqëson Shoqatën dhe pranon të gjitha shkresat zyrtare në emër të Shoqatës.
12. Kryetarja e Shoqatës duhet të jetë përgjegjëse për informimin e autoriteteve relevante administrative për çfarëdo ndryshimi në Shoqatë.

#### **Neni 20** **Sekretarja e Përgjithshme**

1. Sekretarja e Përgjithshëm Shoqatës:
  - 1.1 Pranon dhe zbaton detyra dhe përgjegjësi që epen nga Kryetarja, Bordi Drejtues dhe Nënkyetarja.
  - 1.2 Ndihmon në përgatitjen dhe organizmin e mbledhjeve të Bordit Drejtues të Kuvendit.
  - 1.3 Kujdeset dhe mirëmban procesverbalet dhe dokumentacionin e Shoqatës.
  - 1.4 Kryen detyra të tjera të parapara me këtë Statut.
  - 1.5 Përgatit raportin përmbledhës vjetor dhe me aprovim të Bordit Drejtues behët publik.

#### **Neni 21** **Bordi Drejtues**

1. Shoqata do të menaxhohet nga Bordi Drejtues, i cili do të ketë për detyrë veprimin në emër të Shoqatës, në pajtim me qëllimet e shoqatës, dhe do të ushtrojë autorizimet e tjera të përcaktuara me këtë Statut.
2. Përpos kompetencave të dhëna me këtë statut, Bordi drejtues do të ketë gjithashtu edhe këto kompetenca:

- a) Përfaqëson Shoqatën dhe vepron në emër të saj;
  - b) Nxjerr aktin emërues për Kryesuesën e Bordit Drejtues, e cila është edhe Kryetare e Shoqatës.
  - c) Është përgjegjës që e gjithë veprimtaria e ShGPK-së të kryhet në pajtim me ligjet dhe rregullat në fuqi në Kosovë;
  - d) Ndihmon Kryetaren në sigurimin e fondeve për veprimtarinë e ShGPK-së;
  - e) Pranon dhe miraton planet tremujore të punës së Shoqatës;
  - f) Pranon dhe miraton raportet tremujore mbi punën e Shoqatës;
  - g) Përgatit seancat e Kuvendit të Shoqatës;
  - h) Merr vendime financiare dhe udhëheq pasurinë e shoqatës;
  - i) Përgatit propozimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të Statutit, të cilat ia parashtron Kuvendit për aprovim;
  - j) Nxjerrë aktet e tjera të Shoqatës, përveç Statutit;
  - k) Vendosë për bashkëpunimin dhe lidhjen me shoqata e institucione të tjera;
  - l) Formon komisione të përhershme dhe grupe punuese të ShGPK-së;
  - m) Vendos për formimin e njësisve tjera organizative të shoqatës;
  - n) Vendos për anëtarë plotësues të Bordit Drejtues për çështje të caktuar dhe kohë të caktuar;
  - o) Vendos për formimin e komisioneve, grupeve punuese, ndihmese sipas kërkesave që paraqiten gjatë realizimeve të aktiviteteve të shoqatës.
  - p) Vendos për pjesëmarrjen dhe nominimit e anëtarëve të Shoqatës në seminare, konferenca, trajnime etj.;
  - q) Përgatit raport vjetor për të veprimtarinë dhe të arriturat e shoqatës, i cili raport miratohet në kuvend;
  - r) Përgatiti planin e punës për Bordin Drejtues;
  - s) Është përgjegjës për informimin e anëtarëve dhe opinionit për punën dhe aktivitetet e ShGPK-së.
  - t) Ushtron të drejtat e punëdhënësit kur Shoqata vlerëson të nevojshme të punësojë me kohë të plotë ose të pjesshëm;
3. Bordi Drejtues përbëhet nga secili rajon policore si dhe Drejtorinë e Përgjithshme, Policia Kufitare përfshihet nën Drejtorit Rajonale të kompetencës territoriale.
  4. Bordi Drejtues do të ketë Kryetaren e Bordit Drejtuese cila do të ketë të drejtë të kryesojë të gjitha takimet e Bordit Drejtues dhe të drejtën e votimit. Mandati i saj fillon menjëherë pas skadimit të mandatit të Kryetares paraprake. Pas skadimit të mandatit të saj, Kryetarja mundet me pëlqimin e Bordit, të vazhdojë të mbajë edhe mandate tjera, deri në mbajtjen e Kuvendit të rregullt të radhës. Asnjë person nuk mund të emërohet Kryetare, përveç personave të cilët janë anëtare të Shoqatës.
  5. Të gjithë/a anëtarët e Bordit Drejtues duhet të jenë anëtarë të Shoqatës.
  6. Nënkryetarja dhe Sekretarja mund të përfaqësojnë një nga rajonet apo departamentet policore.
  7. Një anëtar i Bordit Drejtues mund të jetë i gjinisë mashkullore, i cili emërohet nga Bordi Drejtues.

## **Neni 22**

### **Mandati i anëtarëve të Bordit**

1. Mandati i anëtarëve të Bordit Drejtues do të skadojë pas zgjedhjes së pasardhësve të tyre gjatë Kuvendit të Përgjithshëm, përveç nëse rregullohet ndryshe me këtë Statut. Sa u përket mandateve të mbajtura nga persona të cilët janë emëruar për të plotësuar pozitat e lira gjatë një viti të caktuar në Shoqatë, mandatet e tyre do të skadojnë me rastin e emërimit të pasardhësve të tyre gjatë Kuvendit të Përgjithshëm për vitin vijues.
2. Të gjithë anëtarët kompetentë të Bordit Drejtues mund të riemërohen, ri pranohen apo rizgjidhen si anëtarë të Bordit Drejtues.
3. Procedurat e Bordit Drejtues nuk do të anashkalohen për shkak të mosplotësimit të pozitave të lira të anëtarëve të tij, të mos emërimit të tyre apo mos kualifikimit të tyre për pozitën në fjalë.
4. Të gjithë anëtarët e Bordit Drejtues mund të japin dorëheqje në çdo kohë, duke e njoftuar për këtë Sekretarin me shkrim. Në rast se Sekretari jep dorëheqje, njoftimin përkatës duhet t'ia parashtrojë Kryetares.
5. Përveç anëtarëve të pranuar sipas kësaj procedure, Bordi Drejtues mund të ftojë apo lejojë persona të tjerë të marrin pjesë në takimet e veta, pa të drejtën e votës.
6. Bordi drejtues zgjedh arkëtarin e cila duhet të jetë profesioniste në çështje të financave.

## **Neni 23**

### **Mbledhja e Bordit Drejtues**

1. Bordi Drejtues do të mbledhet në së paku dy tri (3) herë brenda një (1) viti. Koha dhe vendi për mbajtjen e mbledhjeve në fjalë do të përcaktohet nga vetë Bordi. Bordi Drejtues do të nxjerr Rregulloren e punës së vet, ndërsa prania e së paku tre (3) anëtarëve të Bordit (përfshirë anëtarët e pranuar më vonë) do të jetë e domosdoshme për kuorum. Pyetjet që paraqiten në mbledhje do të shtjellohen dhe vendimet për to do të merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje, ndërsa në rast të barazimit në votim, Kryetari i Bordit do të ketë të drejtë të dhënies së votës së dytë apo votës vendimtare.
2. Me kërkesë të ndonjë anëtari të Bordit Drejtues, Sekretari do të thërrasë takimin e Bordit Drejtues, duke ua paraqitur të gjithë anëtarëve të tij që gjenden në Kosovë njoftimin me shkrim apo duke ua dërguar atë me postë në adresat e tyre përkatëse.

## **IV ZGJEDHJET E BORDIT DREJTUES**

### **Neni 24**

#### **Mbikëqyrja e zgjedhjeve të Bordit**

1. Bordi Drejtues do të mbikëqyrë të gjitha zgjedhjet e mbajtura në pajtim me këtë Statut. Personat e nominuar nga bordi/ kuvendi, zgjedhën nga Kuvendi Zgjedhor.
  - 1.1 Bordi Drejtues do të emërojë njërin nga anëtarët e vet zyrtar përgjegjës për realizimin e votimeve të cilat mund të konsiderohen të nevojshme.
2. Pozita e anëtarit të Bordit Drejtues do të lirohet:
  - 2.1. Për shkaqe shëndetësore.
  - 2.2. Me dorëheqje për të cilën parashtron njoftim me shkrim tek Sekretari i Shoqatës.
  - 2.3. Nëse ai/ajo nuk merr pjesë në tri apo më shumë takime të njëpasnjëshme të Bordit Drejtues pa ofruar arsye për mungesën në fjalë e cila është e pranueshme për Bordin Drejtues. Bordi Drejtues duhet t'ia dorëzojë anëtarit njoftimin për përjashtimin e tij/saj si anëtar i Bordit Drejtues.
  - 2.4. Nëse ai/ajo e humb anëtarësimin sipas këtij Statuti.
3. Nëse Bordi Drejtues ka arsye të mjaftueshme për t'ia anuluar anëtarësinë e anëtarit të Bordit, ai mund ta bëjë këtë përmes një vendimi të Bordit Drejtues, të nxjerrë në një takim në të cilin anëtari në fjalë është ftuar që të arsyetojë anëtarësinë e saj.

## **V FINANCAT DHE RAPORTIMI**

### **Neni 25**

#### **Pasuria dhe mjetet**

1. Të hyrat e Shoqatës përfshijnë: donacionet në të holla, letrat me vlerë, kontributet në mall, trashëgimitë, anëtarësinë, dhuratat, grantet, pasurinë e tundshme dhe e patundshme si dhe të hyrat e fituara përmes çfarëdo aktiviteteve të ligjshme të Shoqatës me pasurinë dhe mjetet e saja.
2. Shoqata mund të angazhohet në aktivitete ekonomike me qëllim të mbështetjes së aktiviteteve të saja jofitimprurëse dhe me kusht që të hyrat e realizuara nëpërmjet aktiviteteve ekonomike të shfrytëzohen ekskluzivisht për të arritur qëllimet e theksuara në Statutin e Shoqatës.
3. Shoqata mund të ketë dhe të menaxhojë pronë dhe pasuri për të realizuar qëllimet e veta jofitimprurëse.

## Neni 26 Raportimi financiar

1. Arkëtarja e Shoqatës zgjidhet nga votat e anëtarëve të Bordit Udhëheqës dhe kjo pozitë duhet të udhëhiqet nga personi kompetent me përvojë pune në fushën e financave dhe me shkollim adekuat te lartë. Arkëtarja nuk është pjesë e Bordit Udhëheqës.
2. Fondet e Shoqatës duhet të shfrytëzohen me qëllim të arritjes së synimit të Shoqatës, në pajtim me statutin e saj, dhe për asnjë qëllim tjetër.
3. Shoqata mund të grumbullojë të hyra përmes pagesave të anëtarësisë, donacioneve apo në mënyra tjera, me kusht që Shoqata të mos kryejë veprimtari të përhershme tregtare me qëllim të përfitimit financiar.
4. PAGESA VJETORE E ANËTARËSISË DO TË PËRCAKTOHET ME VOTA TË ANËTARËVE GJATË KUVENDIT TË RREGULLT, DHE DUHET TË PARAQITET SI DOKUMENT PËRCJELLËS PËR TË GJITHA KËRKESAT PËR ANËTARËSIM (KJO DO TË PËRDORET VETËM SI DËSHMI DERI TE REGJISTRIMI SI ANËTAR I PARASHTRUESIT TË KËRKESËS). NË RAST SE KËRKESA REFUZOHET, PAGESA E ANËTARËSISË DO T’I KTHEHET PARASHTRUESIT TË KËRKESËS. NUK DO TË KETË KURRFARË KOMPENSIMI TË PAGESËS SË ANËTARËSISË NË RAST SE ANËTARI JEP DORËHEQJE APO TË NJËJIT I SHKËPUTET ANËTARËSIA GJATË VITIT.
5. Bordi Drejtues do të sigurojë mbajtjen e llogarive në pajtim me praktikën e kontabilitetit.
6. Viti fiskal i Shoqatës do të fillojë më 1 Janar dhe do të përfundojë më 31 Dhjetor.
7. Librat e kontabilitetit dhe fletëpagesat duhet të mbahen nga Arkëtari në vendet në të cilat ai/ajo i konsideron adekuate dhe duhet të paraqiten për inspektim nga anëtarët e Bordit Drejtues, në rast kërkesë.
8. Bordi Drejtues kohë pas kohe do të përcaktojë nëse rregullat e kontabilitetit të shoqatës janë duke u respektuar, si dhe masën dhe kushtet nën të cilat ato respektohen. Ky lloj inspektimi do të jetë i hapur edhe për anëtarë tjerë të shoqatës që nuk janë anëtarë të Bordit Drejtues.
9. Asnjë anëtar nuk do të përfitojë në asnjë rast nga fitimet neto të Shoqatës. Kjo nuk ndalon pagimin e shumave të arsyeshme për të kompensuar shërbimet e kryera për Shoqatën apo në emër të saj, me qëllim të arritjes së qëllimeve të saj.
10. Shoqata ka për obligim që të deklarojë pasqyrat financiare në Administratën Tatimore të Kosovës në afatet e përcaktuara me Ligjin në fuqi.

**Neni 27**  
**Mos shpërndarja e të hyrave**

1. Shoqata nuk shpërndan të hyra neto ose fitime për asnjë person.
2. Pasuritë, të hyrat dhe fitimet e Shoqatës përdoren për të mbështetur qëllimet jofitimprurëse të përcaktuara për Shoqatën, siç përcakton ky Statut.
3. Pasuritë, të hyrat dhe fitimet e Shoqatës nuk mund të përdoren për të sjellë drejtpërdrejtë ose tërthorazi përfitime, për ndonjë themelues, drejtues apo zyrtar, anëtar, punonjës ose donatorë të Shoqatës, përveç pagesës apo kompensimit të arsyeshëm për personat që kryejnë punë për Shoqatën

**VI SHUARJA DHE ÇREGJISTRIMI I SHOQATËS**

**Neni 28**  
**Shuarja**

1. Shoqata mund të shuhet në çdo kohë në rast se vendimi nga Kuvendi për shuarje miratohet nga dy të tretat (2/3) e delegateve dhe që votojnë gjatë një mbledhjeje të përgjithshme të thirrur për këtë qëllim, dhe për të cilën njoftimi dhe ftesa janë dërguar me shkrim tek të gjithë anëtarët e Shoqatës jo më vonë se njëzet e një (21) ditë para mbajtjes së saj.
2. Pas shlyerjes të gjitha borxheve dhe mbulimit të gjitha obligimeve, pronat e mbetura do t'i barten një organizate bamirëse apo edukative në Kosovë, sipas vendimit nga Kuvendi i Shoqatës i nxjerrë gjatë takimit kur është vendosur për shpërbërjen e Shoqatës.

**VII NDRYSHIMET E STATUTIT DHE DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE**

**Neni 29**  
**Ndryshimet e Statutit dhe Hyrja në Fuqi**

1. Ndryshimet e këtij Statuti duhet të miratohen nga dy të tretat e anëtarëve të pranishëm që votojnë gjatë Kuvendit të Përgjithshëm. Projektvendimet për ndryshimin e Statutit duhet të pranohen nga Sekretari jo më vonë se njëzetë e tetë (28) ditë para mbledhjes gjatë të cilës ato do të shqyrtohen.
2. Sekretari dhe anëtarët të Shoqatës duhet të njoftohen së paku katërmëdhjetë (14) ditë para mbledhjeve të tilla mbi mbajtjen e tyre. Ky njoftim duhet të përfshijë edhe njoftimin mbi ndryshimet e propozuara dhe arsyet për ndryshimet në fjalë.
3. Statuti hyn në fuqi prej ditës së miratimit ose nënshkrimit nga Kryetarja e Shoqatës.

23.07.2013 dhe të gjitha aktet tjera qe burojnë prej tij, përveç nëse është thënë ndryshe me këtë statut.

5. Amandamenti i statutit behet kur të pranishëm janë 50% + 1 te anëtareve me të drejte vote, me shumicën e votave të anëtarëve prezent.

### Neni 30 Interpretimi

1. Interpretimin e këtij Statuti e bën Kuvendi. Ndërsa, interpretimin e akteve tjera e bën Bordi Drejtues dhe në rast keqkuptimi në mes gjuhëve përparësi ka gjuha shqipe.

Taibe Canolli  
Kryetarja e Shoqatës së Avokatëve në PK

(emri, mbiemri dhe mbiemërtimi)



17.11.2016

(Data e hyrjes ne fuqi )  
Prishtinë,